REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-218/2
Data/Datum/Date: 29/09/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministarke Pravde – Cabinet of the Minister of Justice

---

Nr. 178 /2026
Datë: 21.09.2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8 dhe nenit 11 (paragrafi 4) të Rregullores nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në bazë të nenit 92 dhe 93 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe në mbështetje të nenit 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Hëna Rexhaj, emërohet Këshilltare Politike e Zëvendëskryeministres dhe ministres së Ministrisë së Drejtësisë.

2. E emëruara nga pika 1 e këtij vendimi ushtron përgjegjësitë në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

3. Mandati i të emëruarës në pikën 1 të këtij vendimi fillon me datë 21.09.26 dhe zgjatë deri kur pushon mandati i Zëvendëskryeministres dhe ministres së Ministrisë së Drejtësisë.

4. Të ardhurat personale të të emëruarës nga pika 1 e këtij vendimi do ti paguhen sipas legjislacionit përkatës në fuqi për pagat.

5. Obligohet Departamenti për Buxhet dhe Financa dhe Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Donika Gërvalla-Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe ministre
e Ministrisë së Drejtësisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - QEVERIA E KOSOVËS - MINISTRIA E DREJTËSISË - KABINETI I MINISTRIT - REPUBLIKA KOSOVA - VLADA KOSOVO - MINISTARSTVO PRAVDE - URED MINISTRA - REPUBLIC OF KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO - MINISTRY OF JUSTICE - OFFICE OF THE MINISTER - PRISHTINË/A

Vendimi i'u dërgohet:

- *Të emëruarës znj. Hëna Rexhaj;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe ministres së Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Departamenti për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizioni për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*